



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Nr. 7915 prot.

Korçë, më 12.08.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT,
PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Date **12.08.2025**

Drejtuar: Operatorit ekonomik " VILDEV - CO " sh.p.k, NIPT K83926001F, me adresë: Korçë, Lagjja 7, Rruga Iljaz Bei Mirahori,

- **OE/BOE me nënkontraktor**

PO ☐

JO ☒

-**OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

PO ☐

JO ☒

Tipi i kontrates: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-55897-07-22-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: **"Punime termoizolimi të fasadës së brendshme të pallatit në lgj.12, Blv.Shën. Gjergji, nr 10, Korçë"**

Fondi limit: **4,905,015 (katër milion e nëntëqind e pesë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë, pa tvsh.**

Afati: **30 ditë nga data e lidhjes së kontratës**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **23.07.2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Datë 28.07.2025, Nr.39**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria RSM COMPANY shpk, NIPT 810802422 me vlerën:

3.427.568 (tre milion e katerqind e njezet e shtate mije e peseqind e gjashtedhjetë e tete) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Bashkimi i operatoreve DOKSANI - G shpk, NIPT L21809501H dhe BOROVA D shpk, NIPT

K01722501U me vlerën:

3.436.400 (tre milion e katerqind e tridhjetë e gjashtë mije e katerqind) leke, pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Shoqeria 2AK Group shpk, NIPT M42626404R me vlerën:

4.163.145 (kater milion e njeqind e gjashtedhjetë e tre mije e njeqind e dyzet e pese) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Shoqeria VILDEV - CO shpk, NIPT K83926001F me vlerën:

4.184.670 (kater milion e njeqind e tetedhjetë e kater mije e gjashteqind e shtatedhjetë) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. Shoqeria “KADIA” shpk, NIPT J66703117R me vlerën:

4.298.385 (kater milion e dyqind e nentedhjetë e tete mije e treqind e tetedhjetë e pese) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

6. Shoqeria “DRINI-1” shpk, NIPT J78716317H me vlerën:

4.349.100 (kater milion e treqind e dyzet e nente mije e njeqind) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐JO ☒

7. Shoqeria “NIKA shpk, NIPT J76705047U me vlerën:

4.559.835 (kater milion e peseqind e pesedhjetë e nente mijë e teteqind e tridhjetë e pesë) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqeria RSM COMPANY shpk, NIPT 810802422 per arsye se:

Komisioni i Vleresimit të Ofertave, mbas verifikimit të ofertave beri llogaritjet per te percaktuar nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit dhe ne nenin 82 pika 4 të VKM 285 date 19.05.2021”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se “në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlера e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme”

Mbas llogaritjeve te bera u konstatua se oferta juaj eshte me cmim anomalisht te ulet,ne keto kushte oferta refuzohet bazuar ne neni 93 pika 5 e Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr nr. 16/2024, datë 8.2.2024 dhe neni 82 pika 4 të VKM 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se: “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.”

2. Shoqeria 2AK Group shpk, NIPT M42626404R per arsye se:

Bazuar ne Neni 92 pika 3 te Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr nr. 16/2024, datë 8.2.2024 si dhe Neni 82 pika 2 i VKM-se 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme” Komisioni i Vleresimit te Ofertave skualifikon operatorin ekonomik pasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 34 persona, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Bazuar në neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” pika 2 paragrafi 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”. Subjekti ofertues duhet të dispononte si fuqi puntore të paktën 17 (shtatëmbëdhjetë) puntorë. Subjekti ofertues ka deklaruar 2 (dy) punonjë në Formulari i vetëdeklarimit. Si rrjedhojë, ofertuesi 2AK Group nuk plotëson kërkesën nr. 2.2.4 të dokuemteve të tenderit, dhe KVO e s’kualifikon.

2. Bashkimi i operatoreve DOKSANI - G shpk, NIPT L21809501H dhe BOROVA D shpk, NIPT K01722501U per arsye se:

Në Shtojcën 2 “Lista e cmimeve sipas zerave te preventivit” kërkohet: “Të gjithë zërave në formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zerat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton se nuk është vendosur vlerë për zërin e preventivit “Fondi rezervë (5.0 %)”.

Si rrjedhojë, bazuar në Neni 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 8.2.2024 si dhe Neni 82 pika 2 i VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave skualifikon operatorin ekonomik sepse nuk i është përmbajtur preventivit të publikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ofertuesin VILDEV - CO shpk, NIPT K83926001F, me adresë: *Korçë, Lagjja 7, Rruga Iljaz Bei Mirahori*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **4.184.670 (kater milion e njeqind e tetedhjetë e kater mije e gjashteqind e shtatedhjetë) leke pa tvsh** është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**